

## Zhvillohet takimi i punës me ekspertët e SAI-t të Norvegjisë (Office of the Auditor General of Norway)

Në datat 18 Janar 2022 dhe 19 Janar 2022, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvillua një takim pune ndërmjet ekspertëve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Norvegjisë dhe disa prej audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Ky takim kishte në fokus diskutimin dhe përcaktimin e kornizave themelore të domosdoshme për vijimin e suksesshëm të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve në të ardhmen. Kryesisht këto diskutime u trajtuan me një vëmendje të veçantë në drejtim të fillimit të bashkëpunimit me SAI-n e Norvegjisë në fushën e auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe mbështetjes që SAI i Norvegjisë kërkon të japë për Kontrollin e Lartë të Shtetit me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të institucionit në drejtim të këtij lloji auditimi. Ky takim erdhi si vijim dhe rezultat i fillimit të bashkëpunimit institucional në disa fusha, ndërmjet KLSH-së dhe SAI-t të Norvegjisë.

KLSH në këtë takim u përfaqësua nga z. Aldo Kita, Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, z. Benard Haka, Kryeauditues në Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, z. Rigels Guzi, Auditues i Lartë në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit dhe auditues të institucionit, kryesisht në Departamentin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit por edhe në departamente të tjerë si atë të Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore, Departamentit të Auditimit të Performancës, Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit etj.

Nga SAI i Norvegjisë morën pjesë ekspertët e lartë: znj. Gry Anette, znj. Jorild Skrefsurd dhe z. Borre Lagesen.



Temat që u trajtuan përgjatë takimit me kolegët Norvegjezë ishin:

- Diskutimi dhe përcaktimi i konceptit të IT –Audit dhe kuptueshmëria e tij sipas SAI-ve;
- Diskutimi mbi eksperiencat e mëparshme të mbështetjes që SAI i Norvegjisë ka ofruar për SAI-et homologe në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të auditimit të Teknologjisë së Informacionit;
- Diskutimi dhe njohja me planin vjetor të auditimeve të Teknologjisë së Informacionit që KLSH ka parashikuar të realizojë për vitin 2022;

- Diskutimi mbi qëllimet dhe objektivat që do të kërkohet të arrihen përmes projektit të bashkëpunimit ndërmjet dy institucioneve;
- Diskutimi se cila do të jetë qasja e duhur dhe mënyra më e mirë për bashkëpunimin ndërmjet dy institucioneve në ndihmesë të aktivitetit të KLSH-së;
- Prezantimi nga ekspertët Norvegjezë i shembujve praktikë për metodologjinë dhe teknikat konkrete të ndjekura në projekte të mëparshme të ngjashme;
- Diskutimi i metodologjisë dhe përcaktimi i çështjeve dhe objektiveve konkretë për hapat e mëtejshëm që do të ndjekë ky bashkëpunim institucional me përfitim të dyanshëm.

Përgjatë takimit audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit prezantuan për kolegët norvegjezë metodologjinë dhe metodikat e punës që institucioni ndjek për realizimin e projekteve të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në veçanti por edhe të të gjithë projekteve të auditimit që realizohen nga KLSH në tërësi. Ndërkohë, kolegët norvegjezë prezantuan mjetet dhe mundësitë që Zyra Kombëtare e Auditimit të Norvegjisë mund të vendosë në dispozicion të KLSH-së me qëllim zhvillimin dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të audituesve. Gjithashtu, në këtë takim u diskutuan dhe strategjitë dhe masat që institucionet do të ndërmarrin në vijim me qëllim që objektivat dhe qëllimet e këtij bashkëpunim të realizohen me sukses.

Në përfundim të këtij takimi frytdhënës për të dy institucionet u përcaktuan kornizat dhe termat kryesorë për zbatimin dhe realizimin me sukses të këtij projekti bashkëpunimi dhe hapat e mëtejshëm konkretë që do të ndiqen në kuadër të këtij bashkëpunimi.